



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE  
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA  
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

**VENDIM**

**Nr.28, datë 23.06.2023**

**PËR  
“SHTYRJE AFATI TË APLIKIMIT NGA SHOQËRITË UJËSJELLËS-  
KANALIZIME PËR TARIFA TË UJIT TË PIJSHËM DHE UJËRAVE TË  
NDOTURA PËR VITIN 2023”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” i ndryshuar, të “Rregullores për organizimin e brendshëm të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura”, Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR),

**KONSTATOI SE:**

Në ligjin nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” i ndryshuar, neni 14 pika b, përcaktohet se një ndër kompetencat e KKRR-së është “ *të miratojë çmimet dhe tarifat e shitjes së ujit, me shumicë dhe pakicë, tarifat për ujërat e përdorura dhe tarifat e trajtimit të tyre...*”. Gjithashtu në nenin 22 të po këtij ligji përcaktohen procedurat për vendosjen e tarifave, ku në zbatim të këtij ligji, KKRR përcakton metodologjinë e përlllogaritjes së tarifave e cila është miratuar me Vendimin nr. 539, datë 30.12.2021 “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës - kanalizime”.

Me miratimin e VKM Nr.302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” është realizuar agregimi i 12 shoqërive ujësjellës kanalizime nga 15, por që për arsye objektive nuk është përfunduar plotësisht procesi i riorganizimit të brendshëm në shoqëritë e reja rajonale. Neni 10, pika 4 e Vendimit nr. 539, datë 30.12.2021 përcakton se “*Afati përfundimtar për paraqitjen e dokumentacionit të plotë të aplikimit për nivel të ri të tarifave është data 30 Qershor..*”. Nga informacioni dhe të dhënat e marra në vazhdimësi nga shoqëritë e reja rajonale si dhe nga kërkesat e paraqitura nga donatorët, konstatohet se ky afat nuk mund të

respektohet në kohën e duhur për arsye të riorganizimit dhe vështirësive të hasura në praktikë nga ana e tyre për plotësimin brenda afatit të aplikimit për nivel të ri tarifor sipas metodologjisë së tarifave, për këto fakte me qëllim dhe përkrahjen e reformës në sektorin ujësjellës-kanalizime del e nevojshme shtyrja e afatit të aplikimit për këto shoqëri përjashtimisht për vitin 2023.

Sa më sipër, në mbledhjen e datës 23.06.2023, Komisioni Kombëtar Rregullator:

### **VENDOSI**

1. Përjashtimisht për vitin 2023, afati përfundimtar për paraqitjen e dokumentacionit të plotë të aplikimit për nivel të ri të tarifave për shoqëritë UK Rajonale është data 31 gusht.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi të gjitha shoqëritë rajonale ujësjellës-kanalizime dhe të gjitha strukturat e Entit Rregullator të Ujit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Ndriçim Shani**